

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMLORE NË GJILAN, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues – gjyqtarit Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit V. R. nga Gj., rr. ”... ” pa nr. të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat S. M., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr. 199/2016, të datës 30.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 28.10.2016, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari V. R., nga i ati B., dhe nëna N., e lindur M., i lindur ..., në Gj. ku edhe jeton rr. ”...” pa numër banesa përball ... ende nuk ka numër, i martuar, baba i ... fëmijëve, i punësuar në botën e jashtme në ..., punëtor sezone, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se më datë2016, rreth orës.. në rrugën ”...” në Gj., në oborrin e Restorant ”...” pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë, edhe atë revolen e markës ”...” me nr. ..., ... karikator dhe ... copë fishek, e të cilat ditën kritike i gjenden dhe sekuestrohen nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Me çka ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41, 46, 69, 73, 114, dhe 374 par. 3 të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Të akuzuarin V. R., me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata do të ia zëvendësoi me dënim burgu ashtu që do të i llogaritet shuma prej 20 euro për një ditë burgimi.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi revolen e markës "... " me nr. ... dhe .. karikator dhe ... copë fishek.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti i Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr. 199/2016, të datës 30.08.2016, kundër të akuzuarit V. R., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti për krime të rënda Arben Kadriu, fillimisht mbeti pranë aktakuzës e më pas shtoi se pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpalli fajtor dhe ta dënoi me dënim meritor. Me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh edhe rrethanat lehtësuese edhe ato rëndueses në mënyrë që dënimi të jetë në proporcion me peshën e veprës penale.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare e të akuzuarit V. R., avokat S. M., nga Gj., deklaroi se meqë i pandehuri e ka pranuar fajësinë mbrojtja nuk do të lëshohet

në elaborimin e gjendjes faktike dhe juridike, ashtu siç përmban akuza. I propozoi Gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit të marrë parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi këtë bazë të shqiptoi një dënim të arsyeshëm e më konkretisht propozojmë Gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim me gjobë ngase i pandehuri gjendet në botën e jashtme dhe se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që i pandehuri në të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale.

I akuzuari V. R., fillimisht e pranoi fajësinë për veprën e kryer penale dhe shtoi se përkrahu në tërësi fjalën e mbrojtësit tim avokat S. M., i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale e di se kam gabuar me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale, kam mendu se pasi që kjo armë është vetëm me gas dhe nuk i shkaktoi askujt lëndime, e po ashtu nuk e kam ditur se me këso lloj armësh bëjë vepër penale. Andaj, kërkoj nga Gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të but që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës veçanërisht formular prone i datës2016, lista e armëve të sekuestruara si dhe foto dokumentacionin edhe atë 2. fotove foto dokumentacionin me 10 fotografi, dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari V. R. ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se për herë të parë është ndeshur me ligjin. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit të veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPK-ës.

Vendimi mbi dënimin plotësues është bazuar në nenin 69 si dhe 374 par. 3 të KPRK-së ashtu që të akuzuarit V. R. janë gjetur dhe i janë konfiskuar edhe atë një revolen e markës “...” me nr. ..., ... karikator dhe ... copë fishek.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 205/2016 Me datë 28.10.2016

Sek. Juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE, kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.